



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 69, datë 23.07.2015

PËR

**MIRATIMIN E DISA SHITESAVE DHE NDRYSHIMEVE NË RREGULLOREN
NR. 155, DATË 23.12.2014 “PËR PËRCAKTIMIN E ELEMENTËVE TË
PËRLLOGARITJES DHE NIVELET E TARIFAVE QË U NGARKOHEN
SUBJEKTEVE TË MBIKËQYRURA, SI DHE PROCEDURAT E ARKËTIMIT
DHE RAKORDIMIT TË TYRE”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 13 të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, dhe nenit 128, të Kodit të Procedurës Administrative, me propozim të Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme,

V E N D O S I :

1. Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Rregulloren nr. 155, datë 23.12.2014 “Për përcaktimin e elementëve të përlllogaritjes dhe nivelet e tarifave që u ngarkohen subjekteve të mbikëqyrura, si dhe procedurat e arkëtimit dhe rakordimit të tyre”, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme për njoftimin, ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Enkeleda SHEHI

- Shtesat dhe ndryshimet në Rregulloren nr. 155, datë 23.12.2014 “Për përcaktimin e elementëve të përlogaritjes dhe nivelet e tarifave që u ngarkohen subjekteve të mbikëqyrura, si dhe procedurat e arkëtimit dhe rakordimit të tyre”, dhe anekset që e shoqërojnë atë:

1. Në nenin 3, shtohet pika d) me përmbajtje si më poshtë:

“d) Tarifë për trajnime për kualifikim profesional dhe edukim në vazhdim prej të cilave përfitojnë subjektet e mbikëqyrura.

2. Pas nenit 7, shtohet neni 7/1 me titull dhe përmbajtje si më poshtë:

“Neni 7/1

Tarifa për trajnime për kualifikim profesional dhe edukim në vazhdim

1. *Tarifa për trajnime për kualifikim profesional janë tarifat që paguhen nga personat fizikë dhe juridikë të cilët aplikojnë për t’u pajisur me certifikatë të kualifikimit profesional.*
2. *Tarifa për trajnime për edukim në vazhdim janë tarifat që paguhen nga personat fizikë dhe juridikë të cilët aplikojnë për t’u pajisur me certifikatë të edukimit në vazhdim.*
3. *Tarifat për trajnime për kualifikim profesional dhe edukim në vazhdim do të paguhen përpara zhvillimit të çdo trajnimi. Tarifa e trajnimit për kualifikim profesional për profesionin e aktuarit do të kryhet me tre këste”.*

3. Në Ankesin I, pikat 3, 4, 5, 6 bëhen ndryshimet si më poshtë:

	Subjektet	Tarifë për depozitim dokumentacioni	Tarifë për marrje licence ose miratime	Tarifë për ushtrim veprimtarie	Të tjera
I.	TREGU I SIGURIMEVE				
1	Shoqëri sigurimi/risigurimi	20.000 lekë	250.000 lekë	1,5% të primeve bruto	Zgjerim veprimtarie 100.000 lekë
2	Shoqëri agjentësh/banka dhe intituc të tjera si agjentë	2.000 lekë	20.000 lekë	-	Rinovim licence 10.000 lekë
	Agjent - person fizik	1.000 lekë	10.000 lekë	-	Rinovim licence 5.000 lekë
	Punonjës shitës i shoq së sigurimit	-	2.000 lekë	-	-

3	Shoqëri brokerimi/ banka si shoq brokerimi	20.000 lekë	30.000 lekë	-	-
	Broker - person fizik	2.000 lekë	20.000 lekë	-	<i>Kualifikim profesional</i> <i>10.000 lekë</i> <i>Edukim në vazhdim</i> <i>5.000 lekë</i>
4	Aktuar	-	50.000 Leke	-	<i>Rinovim licence</i> <i>20.000 leke</i> <i>Kualifikim profesional</i> <i>560.000 lekë</i> <i>Edukim në vazhdim</i> <i>10.000 lekë</i>
5	Shoqëri per vlerësim dëme në sigurime	20.000 lekë	30.000 lekë	-	-
	Vlerësues dëmesh – person fizik	-	50.000 lekë	-	<i>Rinovim licence</i> <i>30.000 leke</i> <i>Kualifikim profesional</i> <i>10.000 lekë</i> <i>Edukim në vazhdim</i> <i>5.000 lekë</i>
6	“Miratim administrator / anëtar bordi drejtori / anëtar i këshillit mbikëqyrës / administrimi”	10.000 lekë (per cdo miratim)			

4. Në fund të Aneksit 1 shtohet Shënimi 3 me këtë përmbajtje:

“Shënim 3: Kësti i parë i pagesës për kualifikim profesional për aktuar do të jetë në vlerën 200.000 lekë dhe do të paguhet menjëherë përpara se të fillojë trajnimi. Kësti i dyte në vlerën 200.000 lekë do të paguhet mbas mbarimit të modulit nr. 5 dhe kësti i fundit në vlerën 160.000 lekë do të paguhet mbas mbarimit të modulit nr. 10.”